



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr.190, datë 27.06.2023

PËR
“RENDITJEN E KANDIDATËVE PËR POZICIONIN VAKANT NR.4 NË
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DURRËS, SHPALLUR ME VENDIMIN
NR.92, DATË 09.05.2023 TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 90, pika 2 të “Kodit të Procedurave Administrative”, nenin 43 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 43 dhe 44 të Rregullores “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” të ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të për gatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

- I. Miratimin e renditjes së kandidatëve për pozicionin vakant Nr.4, shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr.92, datë 09.05.2023, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës si më poshtë:
 1. Ilir Hoxha
 2. Alma Bramo
- II. Mos vazhdimin e procedurës së transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, për kandidatët Erida Visoçi dhe Françesk Ganaj.
- III. Relacioni i Komisionit për Zhvillimin e Karrierës është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- IV. Të njoftojë të gjithë kandidatët për këtë vendim.
- V. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e njoftimit të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
- VII. U shpall në Tiranë, sot më 27.06.2023.



KRYETAR
Alfred Balla

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj


ANËTAR
Sokol Stojani



ANËTAR
Eloida Goxhi



ANËTAR
Mirela Bogdani




ANËTAR
Bujar Sheshi



ANËTAR
Esmeralda Keshi



ANËTAR
Arta Mandro



ANËTAR
Nurihan Seti



ANËTAR
Zeqir Hoda



ANËTAR
Ledina Riza

